



UNIVERSITETI I TIRANËS
Senati Akademik

VENDIM

Nr. 11 datë 26.04.2017

***“Mbi një korrigjim në planin mësimor të ciklit të dytë të studimeve
“Master Profesional” në “E Drejtë Publike”,
për vitin akademik 2016-2017”***

Bazuar në ligjin Nr.80/2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”, neni 3; neni 25; neni 37, pikat 1 e 2; neni 38; në Statutin e Universitetit të Tiranës, neni 19; si dhe në propozimin e Fakultetit të Drejtësisë me shkresë Nr.270/2 Prot., datë 23.03.2017, në mbledhjen e datës 26.04.2017 Senati Akademik i Universitetit të Tiranës;

VENDOSI:

1. Të miratojë propozimin e Fakultetit të Drejtësisë për një korrigjim në planin mësimor të programit të studimit “Master Profesional” në “E Drejtë Publike”, mbi zhvendosjen e lëndës me zgjedhje “Klinika e ligjit 2” nga semestri parë i vitit të dytë në semestrin e dytë të vitit të parë, për shkak të gabimit në renditjen e lëndëve me zgjedhje.
2. Ngarkohet Fakulteti i Drejtësisë për zbatimin e këtij vendimi.
3. Ky vendim hyn në fuqi për vitin akademik 2016-2017.

KRYETARI

PROF.DR.MYNYR KONI